

VENDIM
Nr. 808, datë 21.10.2020

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL TE BASHKIA SARANDË, TË PASURISË 5/61, ZONA KADASTRALE 8642, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 421, DATË 9.6.2005, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR NDRYSHIMIN DHE KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË OBJEKTIT ‘ZYRAT DHE OFIÇINA’, SARANDË, NGA MINISTRIA E BUJQËSISË DHE E USHQIMIT MINISTRISË SË TRANSPORTIT DHE TË TELEKOMUNIKACIONIT DHE TË OBJEKTIT ‘ISH-PARKU I MALLRAVE’, SARANDË, NGA MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE E TELEKOMUNIKACIONIT MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 226, DATË 23.4.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT TË TRANSPORTIT RRUGOR, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË TRANSPORTIT DHE TË TELEKOMUNIKACIONIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, shkronja “g”, 5 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 2, të vendimit nr. 421, datë 9.6.2005, të Këshillit të Ministrave, sipërfaqja e pronës me emërtimin “Ish-Parku i Mallrave”, Sarandë, me numër pasurie 5/61, zona kadastrale 8642, ndryshon sipas formularit, gjithsej, 1 (një) fletë dhe hartës kadastrale, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, transferohet në pronësi, nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural te Bashkia Sarandë, sipas formularit, gjithsej, 1 (një) fletë dhe hartës kadastrale, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, me qëllim për t’u përdorur në fushën e infrastrukturës.

3. Bashkisë Sarandë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Bashkia Sarandë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PA
(Per inventarizimin e pronave te veça

Bashkia Sarandë				Identifikoi: Taulant Hyseni (emri, mbiemri, pozic)			
				Supervizoi: Pandi Zhonga (emri, mbiemri, pozic)			
Fusha e përdorimit të Pronës: SA.IN.39: Rëzhvillim, Nënkatëgoria: Terminal i Autobusave				Aprovi: Adrian Gurma (emri, mbiemri, pozic)			
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartës	Nr. Pasurisë	Lloji i Pronës	Emri i Pronës Adresa	Sip. Totale e Pronës m2	Nga Sip. Totale: Sa Ndërtesë (m2)	Funksioni për të cilin përdoret Prona
1	2	3	4	5	6	7	8

HARTË KADASTRALE

BASHKIA SARANDË KRYETAR <i>[Signature]</i> ADRIAN GURMA		A. IDENTIFIKIMI I PASURISË ZONA KADASTRALE: 8642 INDEKSI I HARTËS: SR; E ADRESA E PASURISË: SAF	
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT DREJTOR : ARK. PANDI ZHONGA PUNOI : TOPOGRAF ZYLFO PASHA PUNOI : ING. TAULANT HYSENI		B. KUFIZIMET VERI : PAS NR.5/34; NR.5/35; NR.5/36 JUGU : PASURIA NR.6/192 (R) LINDJE : RRUGË PERËNDIM : PASURIA NR.5/51 DATA : 24.06.2020	

KOORDINATAT E TRUALLIT SIPAS KRGJSH-2010				KOORDINATAT E TRUALLIT SIPAS ALBANIAN1986/ GA			
A	E=499476.53	N=4415581.36		A	Y=4414056.3	X=4414056.3	
B	E=499525.51	N=4415576.84		B	Y=4414105.6	X=4414105.6	
C	E=499522.19	N=4415538.17		C	Y=4414101.5	X=4414101.5	
D	E=499472.91	N=4415542.72		D	Y=4414052.1	X=4414052.1	